

Kompetencat profesionale për Drejtimin PYJE, Niveli I

Nxënësi është i aftë:

- ✓ të identifikojë llojshmërinë e drurëve dhe shkurreve pyjorë, bimëve eterovajore, mjekësorë e industriale që rriten në mënyre spontane dhe të kultivuar në vendin tonë;
- ✓ të përdorë dhe mirëmbajë mjetet ndihmëse dhe mekanizmat në operacionet e prodhimit të materialit drusor në pyll;
- ✓ të respektojë standardet e asortimenteve që prodhohen në pyll;
- ✓ të kryejë transportin ajror me teleferik, me një litar dhe me 2 litarë ose zbritëset e thjeshtë;
- ✓ të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit;
- ✓ të lexojë dhe interpretojë skema të thjeshta të punimeve në pyje;
- ✓ të realizojë nxjerrjen e farave nga frutat e drurëve pyjorë;
- ✓ të përgatisë tokën për mbjellje në fidanishte dhe të mbjellë atë;
- ✓ të realizojë shërbime mbas mbjelljes së farave;
- ✓ të realizojë hapje të gropave dhe të mbjellë fidana;
- ✓ të identifikojë dhe të njohë llojet kryesore pyjorë të vendit tonë;
- ✓ të ndihmojë në kryerjen e punimeve të sistemimeve malore dhe rrugëve pyjore;
- ✓ të përzgjedhë kulturat për krijimin e kopshtit të shtëpisë (fermës) dhe kombinimin e tyre në varësi të kushteve ekologjike si dhe traditës së zonës;
- ✓ të përcaktojë hartën e bimësisë në pyll si dhe karakteristikat e tyre;
- ✓ të kryejë prerje kulturore në pyje;
- ✓ të organizojë dhe të planifikojë zbatimin e prerjeve kulturore dhe kryesore në pyje;
- ✓ të përdorë hartat në terren si kusht i domosdoshëm për orientimin në pyll;
- ✓ të realizojë skica dhe vizatime teknike bazuar në njohuritë e përgjithshme që ka marrë nxënësi;
- ✓ të marrë një sipërfaqe provë si pikë që përfaqëson kushtet mesatare të parcelës;
- ✓ të marrë të dhëna në terren që shërbejnë për hartimin e një plani mbarështrimi;
- ✓ të përdorë dhe të marrë të dhëna nga një plan mbarështrimi;
- ✓ të përdorë mjete dhe metoda për uljen e veprimit të dëmtesve në pyll;
- ✓ të kryejë punime për mbrojtjen e pyllit nga zjarri;
- ✓ të përdorë mjetet matëse të thjeshta që përdoren në pyje, si metër shirit, nivelues teodolit;
- ✓ të përdorë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës në punimet e shfrytëzimit në pyje;
- ✓ të kryejë punime të tilla si pastrime hapje rrugësh, pastrime degësh me vegla dore dhe me mjete elektrike;
- ✓ të përdorë hartën dhe të dijë të orientohet në pyll nëpërmjet busullës;
- ✓ të përcaktojë moshën e shfrytëzueshmërisë dhe damkosjen e tyre.
- ✓ të realizojë parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet mbarështrimi pyjor.
- ✓ të përcaktojë karakteristikat dendrometrike të grumbullit;
- ✓ të përcaktojë diametrin mesatar dhe lartësinë mesatare duke përdorur mjetet matëse;
- ✓ të njohë faunën e florën e Shqipërisë si dhe të mbrojë ato;
- ✓ të interpretojë dobinë dhe vlerat e llojshmërisë së faunës;
- ✓ të klasifikojë kafshët e dobishme dhe të dëmshme të pyllit;
- ✓ të kuptojë strukturën e ekosistemit të një pylli, dinamikën dhe proceset që ndodhin;
- ✓ të përcaktojë rritjet e grumbullit pyjor;
- ✓ të njohë metodat e mbrojtjes së pyjeve, pesticidet kryesore si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Vocational Competencies obtained in FORESTRY branch, Level I

The student is able to:

- ✓ Identify the type of forest trees and bushes, and ethero-oleaginous, medical, and industrial trees that grow spontaneously, or cultivated, in our country.
- ✓ Use and maintain the support tools and mechanisms in wood production operations in the forests.
- ✓ Respect the standards of the assortments produced in the forest.
- ✓ Carry out transport by cable car with 1 or 2 ropes or simple transporters.
- ✓ Interpret the technical documentation.
- ✓ Read and interpret simple drawings of forest works.
- ✓ Extract seeds from forest fruit trees.
- ✓ Prepare land for planting seedlings and plant them.
- ✓ Realize after-seed planting services.
- ✓ Dig holes for planting seedlings.
- ✓ Identify and recognize the main types of forest trees in our country.
- ✓ Help with mountainous works and forest pathways.
- ✓ Select cultures for home/farm gardens and combine them with the local area ecology and tradition.
- ✓ Compile a map of forest trees and their features.
- ✓ Cut specific cultures of forest trees.
- ✓ Organize and plan cutting of main cultures of forest trees.
- ✓ Use maps as an indispensable tool of orientation in the forest.
- ✓ Make technical drawings and schemes based on general knowledge obtained.
- ✓ Select a representative sample of the forest.
- ✓ Get data from the field that serve to drafting a cultivation plan.
- ✓ Use and get data about breeding plans.
- ✓ Use methods for reducing the activity that damage the forest.
- ✓ Do forest fire protection works.
- ✓ Use simple measurement tools like tape measure, theodolite leveller, etc.
- ✓ Use and maintain work tools used in forests.
- ✓ Do works like open roads, remove tree branches using hand tools and electric tools.
- ✓ Use the map and compass.
- ✓ Determine the exploitation age and mark them.
- ✓ Apply forest growing principles.
- ✓ Determine the dendrometric features of clusters.
- ✓ Determine the average diameter and height using measurement tools.
- ✓ Recognise the flora and fauna of albania and protect them.
- ✓ Interpret the usefulness and value of fauna variety.
- ✓ Classify the forest helpful and nonhelpful animals.
- ✓ Understand the structure of a forest ecosystem, its dynamics, and processes.
- ✓ Determine the growth of forest collection.
- ✓ Be familiar with forest protection methods, main pesticides, and their use.